

LIGJ Nr. 85/2014 Date 17.7.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 11
Shkalla tatimore**

1. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 2 (dy) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 7,5 (shtatë presje pesë) për qind, por jo më pak se 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në vit.

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 2 (dy) milionë lekë është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në vit.”.

Neni 2

Në nenin 15 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pikat 1, 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“1. Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 2 (dy) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose Postës Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt janar, shkurt dhe mars; brenda datës 20 korrik, për muajt prill, maj dhe qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor.

Tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 2 (dy) milionë lekë në vit paguajnë si tatim të thjeshtuar mbi fitimin një tatim fiks, në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në vit. Kjo pagesë kryhet brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti. Tatimpaguesit me qarkullim nga 0 (zero) deri në 2 (dy) milionë lekë në vit, të cilët fillojnë ushtrimin e aktivitetit gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, paguajnë detyrimin e tyre tatimor proporcional brenda datës 20 dhjetor të vitit vijues.

2. Në rast se aktiviteti i biznesit hapet, mbyllet apo pezullohet gjatë vitit fiskal, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël është proporcional me kohën e zhvillimit të aktivitetit dhe llogaritet në bazë të vetëdeklarimit të tatimpaguesit. Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë gjatë vitit, tatimi

i thjeshtuar mbi fitimin llogaritet në bazë të qarkullimit dhe të fitimit të tatueshëm, të parashikuar nga vetë tatimpaguesi, për periudhën nga data e regjistrimit deri në fund të vitit të parë kalendarik.

3. Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, gjatë periudhës tatimore, vërteton se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, të periudhës paraardhëse, organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të parashikuara me udhëzim të Ministrit të Financave.

3/1. Nëse organet tatimore vlerësojnë dhe kanë të dhëna se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për periudhën vijuese tatimore, do të tejkalojë me më tepër se 10 për qind tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e periudhës së mëparshme tatimore, ato mund të rregullojnë në rritje parapagimet, në përputhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e vlerësuar prej tyre.”.

2. Në pikën 4, pas fjalëve “te bankat e nivelit të dytë” shtohen fjalët “dhe Postës Shqiptare”.

Neni 3

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

Deklarimi

Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim nga 2 (dy) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, tatimi për t’u paguar, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore.

Detyrimin për paraqitjen e deklaratës vjetore në afatin e mësipërm e kanë edhe të gjithë tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 2 (dy) milionë lekë. Këta tatimpagues e plotësojnë këtë deklaratë sipas mënyrës së përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 17.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8666, datë 1.8.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Botuar ne F.Zyrtare 126 / 2014

Dale nga shtypi me 11.08.2014